



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 382 Prot.

Tiranë, më datë 06.08.2018

VENDIM

Nr. 319, datë 27.07.2018

PËR

MIRATIMIN E PROJEKTIT ZHVILLIMOR

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 48, pika 1 dhe neni 134, pika 1, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 27.07.2018, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë edhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin projektit me objekt: “Ndërtimi i Urës së Drojës, me vendndodhje mbi lumin e Drojës, Thumanë, Bashkia Krujë dhe Bashkia Kurbin”, kërkesë e Autoritetit Rrugor Shqiptar;
2. Gjatë procesit të zbatimit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018, “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 134, pika 2;
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR I KKR

Daniel Pirushi



KRYETAR
Mirela KUMBARO FURXHI